

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka kryetare e kolegjit, Nesrin Lushta dhe Salih Toplica anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit P. N. Gj. për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit P. N. Gj., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, PP.nr.1/2016 të datës 05.02.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.209/16 të datës 10.02.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 01.03.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit P. N. Gj., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, PP.nr.1/2016 të datës 05.02.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.209/16 të datës 10.02.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me aktvendimin PP.nr.1/2016 të datës 05.02.2016, të pandehurit P. N. Gj., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 të KPK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data

05.02.2016 deri me 05.04.2016. Masa e paraburgimit iu është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2, të KPPK-së.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.209/16 të datës 10.02.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit P. N. Gj. av. S. L., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndyshojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta ndërpret ashtu që i pandehuri të lëshohet për tu mbrojtur në liri menjëhere.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi kryesisht thekson se në aktvendimet e atakuara nuk janë shënuar ndonjë arsye apo ndonjë fakt vendimtarë me të cilën do të provohej dyshimi i bazuar mirë, se me të dëmtuarin kanë raporte shoqërore dhe një pjesë të parave ia ka kthyer po atë ditë. Sipas mbrojtjes, gjykata me rastin e caktimit të paraburgimit sipas nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 nuk ka dhënë një arsyetim se i pandehuri ku do të ikë, nëse posedon ndonjë dokument të udhëtimit apo nëse ka mjete financiare për të ikur.

Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.18/16 të datës 29.02.2015, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit P. N. Gj. të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e lëndës, kryesisht nga kallëzimi penal, deklaratat e dëshmitarëve, si dhe provat tjera të mbledhura gjerr më tani rezultojnë se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nën par.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së sepse po të gjenden i pandehuri në liri mund të pengojnë rrjedhën e procedurës penale pasi që është ende në fazën e hetimeve duke fshehur, ndryshuar apo asgjësuar provat e veprës penale, duke ndikuar në palën e dëmtuar, në dëshmitarët eventual apo në dëshmitarin B. A. i cili ende nuk ka dhënë deklaratë në prokurori, andaj me lënien e të pandehurit në liri ekzistojnë rrethanat e posaçme se i njejtë mund të ndikojë tek ky dëshmitarë për të dhënë deklaratë në favor të tij dhe me këtë do të pengojë rrjedhën normale të procedurës penale.

Ndërsa, kjo Gjykatë vlerëson se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1, siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, ngase gjykatat nuk kanë dhënë arsye të mjaftuara lidhur me këtë pikë për vazhdimin e paraburgimit se me gjetjen e të pandehurit në liri mund të arratiset apo fshihet me qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të

vlërësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.61/16 datë 01.03.2016.

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka